

L I G J
Nr.9134, datë 11.9.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE S.P.A. ITALI PËR
PROGRAMIN E RISTRUKTURIMIT TEKNIK DHE MENAXHUES TË KESH SHA DHE
FUQIZIMIN E SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale S.p.a. Itali për programin e rristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH sh.a. dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.3970, datë 29.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MCC S.P.A.

Në bazë të nenit 6 të ligjit nr.49, të datës 26 shkurt 1987 të Republikës Italiane, ndërmjet Ministrisë së Financave të Shqipërisë (me cilësinë e Huamarrësit), që vepron në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, e cila përfaqësohet nga Ministri i Financave, Kastriot Islami nga njëra anë dhe Mediocredito Centrale (MCC) S.p.a. e Grupit Bankar Kapitalia, një shoqëri aksionere e regjistruar në Regjistrin e Bankave, me kapital social 475 138 635 euro, me seli në Via Piemonte 51 Romë, regjistruar në regjistrin tregtar, kodi fiskal nr.00594040586, TVSH nr.00915101000 (i cili në këtë Marrëveshje do të njihet si MCC), me cilësinë e administratorit të fondit të krijuar në bazë të nenit 6 të ligjit italian nr.49, datë 26 shkurt 1987, përfaqësuar nga z. Francesco Anania, nga ana tjetër.

Duke pasur parasysh që:

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të Qeverisë së Republikës Italiane, me propozim të Ministrit të Punëve të Jashtme, me dekreten nr.44790, datë 9 maj 2003, ka autorizuar Mediocredito Centrale t'i japë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë një kredi financiare prej 41 528 041, 03 (dyzetë e një milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë e dyzet një pikë zero tre) euro, me këto kushte:

- kthimi: në 36 kështe gjashtëmujore të barabarta dhe të njëpasnjëshme, ku afati i pagimit të kështit të parë mbaron 222 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje financiare;
- përqindja e interesit: 0,40% (zero presje dyzet për qind) interes nominal vjetor, i cili do të paguhet në fund të gjashtëmujorit, ku ky gjashtëmujor, fillon nga data e çdo përdorimi;
- destinacioni: Programi i rristrukturimit teknik e menaxhues të KESH sh.a. dhe të fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar.

Më poshtë Palët bien dakord përsa vijon duke i konsideruar hyrjen edhe anekset si pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1 Përkufizime

Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje financiare dhe të anekseve bashkëlidhur, terminologjia e përdorur do të ketë këtë kuptim:

“Deklarata e borxhit”: është deklarata e cilësuar në nenin 9, me të cilën Huamarrësi merr detyrimin karshi MCC-së për të kthyer kuotat kapital dhe interesat e kësaj kredie financiare;

“Banka agjente”: është banka me filialin në (Romë), e caktuar nga Huamarrësi siç është parashikuar në anekset A dhe C dhe pranë së cilës do të hapet në emër të vetë Huamarrësit një llogari rrjedhëse (e quajtur “Llogari me jashtë”) për akreditimin e fondeve të nevojshme për kryerjen e pagesave të parashikuara në kontratat tregtare;

“Dokumentacioni kontraktual”: është dokumentacioni i parashikuar në kontratën tregtare dhe që përfshin mënyrat e pagesës: (p.sh. faturat, packing list, gjendjen e ecurisë etj.);

“Marrëveshja financiare”: është kjo Marrëveshje financiare, hyrja së bashku me anekset të cilat janë pjesë përbërëse e saj;

“Kredi financiar”: është financimi që MCC, në bazë të autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe me propozim të Ministrit të Punëve të Jashtme, jep sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në hyrje dhe në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje financiare;

“Periudha e lirë” është periudha e cila fillon nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe përfundon 18 vjet nga kjo datë;

“Autoritetet kompetente italiane”: janë Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme, dhe/ose ente të tjera kompetente të Republikës Italiane;

“Plani i prokurimit”: është plani i blerjeve të mallrave, shërbimeve dhe punimeve të caktuara nga Huamarrësi dhe të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim.

“Projekte”/“Programe”: është programi i ristrukturimit teknik e menaxhues të KESH sh.a, si dhe të fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar, i financuar në një pjesë nga kredia financiare; në veçanti programi përfshin: asistencë menaxhimi, furnizim të materialeve elektrike dhe makinave, ndërtimin e nënstacioneve të reja Tirana 2 dhe Tirana qendër, fuqizimi i nënstacioneve të Kasharit dhe Pogradecit, fuqizimin e rrjetit shpërndarës nga nënstacioni Pogradec dhe qytetit të Durrësit;

“Kontrata/t e furnizimit”: është/janë kontrata/t e furnizimit të të mirave dhe/ose shërbimeve nga ana e eksportuesve italianë për importuesit shqiptarë, që lidhen me realizimin e projekteve/programmeve.

Neni 2 Kredia financiare

2.1 MCC i jep Huamarrësit, i cili nga ana e tij e pranon, një kredi financiare në vlerën 41 528 041, 03 (dyzet e një milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë e dyzet e një/zero tre) euro.

2.2 Kjo kredi financiare do të financojë kontratat e furnizimit në lidhje me programin e ristrukturimit teknik e menaxhues të KESH sh.a. dhe të fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar.

2.3 Këto kontrata furnizimi që lidhen me programin në nenin 2.2 do të prokurohen duke ndjekur rregullat dhe procedurat për shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komisionit European në kuadër të bashkëpunimit me vendet e treta (të rishikuara në 2003).

2.4 Përqindja e autorizuar për kosto lokale/vende të tjera për çdo kontratë tregtare do të përcaktohet në planin e prokurimit; megjithatë kjo përqindje nuk mund të jetë më e lartë se 35% (tridhjetë e pesë për qind) e vlerës së përgjithshme të kredisë financiare.

2.5 Bihet dakord që banka agjente në lidhje me këtë kredi financiare do të jetë filiali i (Romës).

2.6 Kredia financiare do të jetë e disponueshme dhe e përdorshme në kohën, mënyrën dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje financiare, me përjashtim të rastit kur autoritetet kompetente italiane vendosin ndryshe.

Neni 3

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

3.1. Që kjo Konventë të hyjë në fuqi, MCC duhet të marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme:

i) Një deklaratë të lëshuar nga organi kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, e cila vërteton autoritetin e Huamarrësit për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Qeverisë shqiptare, këtë Marrëveshje financiare nëpërmjet një personi të autorizuar konform dispozitave legjislative, administrative dhe rregulloreve që janë në fuqi në Shqipëri, si dhe të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

ii) Aktin e caktimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, të personit ose personave të autorizuar për të firmosur Marrëveshjen financiare, njohjen e borxhit (aneksi E) që parashikohet në nenin 9 dhe dokumentet e tjera të parashikuara në këtë Marrëveshje financiare, të cilat i bashkëngjiten në anekset A, B dhe C; ky akt duhet të japë në hollësi emrin dhe pozicionin e këtyre personave dhe të shoqërohet nga “depozitimi” i firmave të tyre; Huamarrësi duhet t’ia dorëzojë këtë akt, “depozitimin” e firmave, si dhe ndryshimet eventuale edhe bankës agjente.

iii) Kopje të instruksioneve, dhënë bankës agjente, për të hapur në emër të Huamarrësit një “Llogari me jashtë” dhe për t’i përdorur fondet e akredituara ekskluzivisht për të kryer pagesat e përcaktuara nga vetë Huamarrësi dhe sipas mënyrave të përcaktuara po nga ai. Instruksionet duhet të hartohen në përputhje me aneksin A, duhet të pranohet shprehimisht nga banka agjente dhe po kjo e fundit t’ia konfirmojë me shkrim Huamarrësit dhe për dijeni MCC.

3.2 MCC, me marrjen e dokumenteve të përmendura më lart, pasi i ka gjetur ato konform kërkesave të tij, i bën të ditur Huamarrësit dhe bankës agjente, me anë të një letre ose telex/faks, i cili duhet të konfirmohet më pas me letër, datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje financiare.

Neni 4

Afatet e përdorimit të kredisë

4.1 Afati i përdorimit të kredisë financiare është 36 muaj duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje financiare. Ky afat mund të zgjatet nga ana e MCC-së. Në kundërshtim me sa më sipër, MCC mund të mos e zgjasë periudhën e përdorimit, në rast se Huamarrësi ose autoritetet kompetente italiane nuk bien dakord për një zgjatje të tillë dhe kanë njoftuar kështu me shkrim MCC të paktën një muaj përpara datës së skadimit të periudhës së disbursimit.

4.2 Në rast se afati i përdorimit ka përfunduar dhe nuk është zgjatur, Mediocredito Centrale, pasi ka marrë mendimin e autoriteteve kompetente italiane, i bën të ditur Huamarrësit dhe Bankës Italo-Shqiptare anulimin e detyrimit lidhur me fondet e papërdorura.

Neni 5

Mënyra e përdorimit të kredisë financiare

5.1 Kredia financiare do të përdoret nga Huamarrësi, në rast se do të përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) dhënia e të drejtës nga ana e autoriteteve kompetente italiane lidhur me përfshirjen e kontratës/ve të furnizimit në kredinë financiare;

ii) rezultati pozitiv i vëzhgimit në kompetencë të Mediocredito Centrale siç parashikohet në nenin 5.2 me poshtë;

iii) marrja nga ana e MCC e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve dhe të letrës udhëzuese bankës agjente siç parashikohet në nenet 6.1 dhe 6.2.

5.2 Në vijim të marrjes të së drejtës, siç parashikohet në pikën 5.1(i), MCC fillon fazën vëzhguese që është kompetencë e saj, e cila parashikon:

i) kontrolle në bazë të dispozitave të dhëna nga autoritetet kompetente italiane, në lidhje me eksportuesin italian dhe kompanitë përkatëse italiane/individë të përfshirë me importuesin lokal dhe lidhur me kontratat e furnizimit. Përsa i përket kontratave të furnizimit, MCC do të verifikojë se ato janë në përputhje me termat dhe kushtet e kredisë financiare dhe janë të detajuara lidhur me kostot/çmimet, me qëllim verifikimet që parashikohen në nenin 7.4;

ii) të njoftojë Huamarrësin për marrjen e autorizimit sipas nenit 5.1 (i) sipër dhe të kërkojë nga Huamarrësi dërgimin e kërkesës sipas nenit 6.1, sikurse edhe letërën e përcaktuar në nenin 6.2.

5.3 Përfundimi pozitiv i kësaj faze vëzhguese nga ana e MCC-së do të bëjë të mundur përfshirjen e kontratave të furnizimit në kreditin financiar. Financimi i kontratave të mësipërme të furnizimit do të bëhet vetëm pas plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 5.1 (iii).

5.4 MCC do të vërë në dijeni Huamarrësin, bankën agjente dhe eksportuesin italian lidhur me përfshirjen dhe financimin e kontratës/ave të furnizimit.

Neni 6

Kërkesa për disbursim

6.1 Menjëherë pas komunikimit për marrjen e lejes, siç parashikohet në nenin 5.1, (i), Huamarrësi do t'i dërgojë Mediocredito Centrale një letër me kërkesën për vënien në dispozicion të fondeve të nevojshme për të përballuar pagesat e parashikuara në çdonjërin nga kontratat e furnizimit. Me anën e kësaj kërkesë, e cila hartohet në përputhje me aneksin B, Huamarrësi njeh mundësinë e financimit dhe rregullsinë e kontratave të furnizimit dhe angazhohet t'i kthejë MCC-së shumën e disbursuar.

6.2 Huamarrësi do t'i dërgojë bankës agjente dhe një kopje MCC-së, për secilën nga kontratat e mësipërme të furnizimit, një letër udhëzuese hartuar në përputhje me aneksin C, e cila duhet të pranohet shprehimisht nga banka agjente, e cila duhet t'ia komunikojë me shkrim Huamarrësit dhe MCC-së.

6.3 Kërkesa dhe letra udhëzuese që parashikohen në nenin 6.1 dhe 6.2 të kësaj Konvente duhet të mbërrijë në kohën e duhur, por gjithësesi jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga data e njoftimit të MCC-së. Me t'u kaluar ky afat, MCC-së do të shqyrtojë, duke marrë edhe mendimin e autoriteteve kompetente italiane, shfuqizimin eventual të kontratave të furnizimit si zë i kredisë financiare.

6.4 Në bazë të udhëzimeve të mësipërme të marra nga Huamarrësi, siç parashikohen në nenin 6.2, banka agjente do t'i kërkojë herë pas here MCC-së, akreditimin në llogarinë me jashtë të fondeve të nevojshme për të kryer pagesat e parashikuara në kontratat e furnizimit, sipas modaliteteve të parashikuara në nenin 7 më poshtë. Banka agjente do të hartojë kërkesat e disbursimit konform aneksit D dhe do t'i dërgojë një kopje Huamarrësit.

Neni 7

Disbursimi

7.1 Duke qenë gjithnjë në fuqi afati i parashikuar në nenin 4.1, secila kërkesë e pjeshme ose e plotë e disbursimit (neni 6.4) duhet t'i mbërrijë Mediocredito Centrale brenda dhe jo më shumë se: (i) 24 muaj nga komunikimi, siç parashikohet në nenin 5.4 ose (ii) në një kohë tjetër (në rast se ka një të tillë) në kontratën e furnizimit. Pas përfundimit të periudhës së përmendur më sipër MCC do të marrë në konsideratë, pas konsultimit me autoritetet kompetente italiane, mundësinë e anulimit të pjesës së papërdorur që lidhet me kontratatën/tat e furnizimit.

7.2 Secila nga kërkesat e disbursimit që parashikohet në nenin 6.4 duhet të paraqitet në përputhje me çdo pagesë që duhet kryer, sipas mënyrave të parashikuara në secilën kontratë furnizuese, me paraqitjen e dokumentacionit kontraktor.

7.3 Dokumentacioni kontraktor do t'i dorëzohet bankës agjente nga eksportuesit italianë, e cila ia nis kopjet e njehsuara me origjinalin Mediocredito Centrale dhe origjinalet Huamarrësit.

7.4 Pas marrjes së çdonjërit nga kërkesat e disbursimit, Mediocredito Centrale do të procedojë me verifikimin e dokumentacionit kontraktual. Ky verifikim i përket përputhjes me këtë dokumentacion kontraktual të kontratës furnizuese përkatëse.

7.5 Mediocredito Centrale do t'i ekzekutojë kërkesat e mësipërme të disbursimit brenda 30 ditëve nga data e marrjes së tyre.

7.6 Në varësi të përfundimit pozitiv të verifikimit që parashikohet në nenin 7.4 më sipër, Mediocredito Centrale do t'i japë bankës agjente udhëzimet e nevojshme për disbursimin e fondeve në llogarinë me jashtë dhe do t'i konfirmojë me telex ose fax Huamarrësit shumën totale të disbursimit dhe datën në të cilën ato janë kredituar.

7.7 Në të njëjtën kohë me kreditimin në llogarinë me jashtë, banka agjente do të kryejë

pagesat në favor të eksportuesve italianë sipas udhëzimeve të dhëna, duke marrë nga eksportuesit italianë deklaratën e pagesës që parashikohet në aneksin F në dy kopje origjinale, një nga të cilat do t'i dërgohet Huamarrësit dhe tjetra Mediocredito Centrale.

7.8 Pas çdo kreditimi fondesh në llogarinë me jashtë dhe kryerjen e pagesave përkatëse në favor të eksportuesve italianë, MCC do t'i dërgojë letër me shkrim Huamarrësit dhe një kopje bankës agjente, planin e shlyerjes së shumës së disbursuar duke përcaktuar datat e duhura në përputhje me nenin 8 më poshtë. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pranimin e këtij plani shlyerjeje.

Neni 8

Shlyerja e kredisë financiare dhe pagimi i interesave

8.1 Çdo shumë e kredituar në "Llogarinë me jashtë" do të kthehet në bazë të një plani shlyerjeje prej 36 kështesh gjashtëmujore, të barabartë dhe të njëpasnjëshëm (kuota principale), ku pagesa e kështit të parë skadon 222 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje financiare. MCC do t'i dërgojë planin e shlyerjes Huamarrësit dhe një kopje bankës agjente, siç është parashikuar në nenin 7.8.

8.2 Mbi kështet e principalit të ngelur të kredituar do të llogariten interesa në masën 0,40% në vit, të barabarta me 0,20% në fund të gjashtëmujorit, duke filluar nga data e kreditimit dhe deri në datën e kthimit të kështit të fundit të principalit. Interesat do të llogariten në bazë muaji 30 ditësh dhe viti 360 ditësh (360/360).

8.3 Gjatë periudhës së shlyerjes, këto interesa do të paguhen në të njëjtën datë skadence me kështet e principalit. Gjatë periudhës *grace* (periudhës së lirë), këto interesa do të paguhen në bazë gjashtëmujori në datat që u korrespondojnë me ditë dhe muaj datave të shlyerjes së kështeve të principalit. Në këtë mënyrë, kuota e parë e interesit mund të përkojë me një periudhë më të shkurtër se gjashtëmujori. Megjithatë, në rast se kjo periudhë është më e shkurtër se 30 ditë, kjo kuotë interesi do të paguhet me kuotën e mëpasshme të interesit. Kuota e parë e interesit, që i përket një periudhe më të gjatë ose më të shkurtër se gjashtëmujori do të llogaritet për ditët që efektivisht kanë kaluar nga data e kreditimit të fondeve në "Llogarinë me jashtë" në datën e pagesës, në bazë të një gjashtëmujori prej 180 ditësh.

8.4 Deri në datën e lëshimit të njohjes së borxhit, nenin 9 më poshtë, pagesa e interesave që lidhen me çdo disbursim do të bëhet në afatet e parashikuara në planet e shlyerjes (neni 7.8); menjëherë pas kësaj date shlyerja e principalit dhe e interesave do të bëhen në afatet e parashikuara në planin e shlyerjes të njohjes së mësipërme të borxhit.

8.5 Për të gjitha shlyerjet dhe pagesat që duhet të bëhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje financiare dhe në bazë të deklaratës përkatëse të borxhit, Huamarrësi ka detyrime të bëjë në kohën e duhur pagesat dhe shlyerjet përkatëse pa vonesa në euro në favor të MCC-së ose të ngarkuarve të saj. Këto shuma do të kreditohen pa asnjë zbritje të detyrimeve bankare dhe/ose valutore dhe fiskale dhe pa qenë nevoja e paralajmërimit nga ana e MCC-së ose të ngarkuarve të saj.

Neni 9

Lëshimi i deklaratës së njohjes së borxhit

9.1 Brenda 60 ditëve nga afati i fundi për përdorimin e kredisë (neni 4.1.), Huamarrësi do t'i lëshojë MCC-së deklaratën e njohjes së borxhit, të firmosur në çdo faqe, të hartuar në përputhje me aneksin E.

9.2 Kjo deklaratë e njohjes së borxhit është lirisht e transferueshme nga MCC tek persona juridikë publikë ose privatë, italianë ose të huaj. Është e qartë se Huamarrësit nuk mund t'i ngarkohen detyrimet për shpenzimet, komisionet, taksat ose tatimet që mund të rrjedhin nga lëshimi eventual i deklaratës së njohjes së borxhit. MCC do t'i bëjë të ditur bankës agjente transferimin e deklaratës së njohjes së borxhit.

9.3 Plani i shlyerjes së kështeve, i përcaktuar në deklaratën e njohjes së borxhit, do të hartohet duke mbledhur të gjitha kështet e principalit dhe interesit që nuk u ka mbaruar ende afati dhe kështet që mund t'u ketë kaluar afati, por që nuk janë paguar në datën e lëshimit të deklaratës së njohjes së

borxhit, të cilat rezultojnë nga planet e veçanta të shlyerjes të përgatitura për çdo disbursim, siç është parashikuar në nenin 7.8.

9.4 Mediocredito Centrale do të depozitojë deklaratën e njohjes së borxhit për ruajtje dhe administrim pranë bankës agjente, pasi të jetë nënshkruar në favor të saj.

9.5 Banka Agjente do të regjistrojë herë pas here në deklaratën e njohjes së borxhit pagesat e shumave të principalit dhe interesit dhe kështu që u ka kaluar afati, dhe që nuk janë paguar. Me t'u kryer të gjitha pagesat e parashikuara në deklaratën e njohjes së borxhit, banka agjente duhet t'ia kthejë këtë të fundit Huamarrësit të firmosur.

Neni 10

Detyrimet e Huamarrësit

10.1 Angazhimi i Huamarrësit për të kryer pagesën e shumave në bazë të kësaj Konvente financiare dhe deklaratës relative të njohjes së borxhit do të jetë autonome, absolute, e pakushtëzuar dhe e parevokueshme.

Neni 11

Pezullimi i disbursimeve

11.1 Mediocredito Centrale gjatë periudhës së disbursimit të kredisë financiare rezervohet të pezullojë çdo kërkesë disbursimi në bazë të nenit 6, në rast se rezultojnë shkelje në lidhje me Mediocredito Centrale në bazë të kësaj Konvente financiare ose kredive të tjera financiare të dhëna nga vetë Mediocredito Centrale, qeverisë ose Bankës Qendrore, ose Enteve të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 6 të ligjit italian nr.38 të 9 shkurtit 1979 dhe të nenit 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987 të Republikës së Shqipërisë, siç mund të ndryshohet herë pas here. Mediocredito Centrale do të japë komunikim të menjëhershëm për pezullimin ndaj Huamarrësit.

11.2 Në rastin kur banka agjente ballafaqohet me pengesa që, për motive të pavarura nga vullneti i saj, nuk e lejojnë t'i japë rrugë instruksioneve të disbursimit nga ana e Mediocredito Centrale në llogarinë me jashtë (shih nenin 7.6), e njëjta bankë agjente do t'i japë komunikim të menjëhershëm me shkrim Huamarrësit dhe vetë Mediocredito Centrale. Në momentin e eliminimit të këtyre pengesave, banka agjente do t'i japë rrugë, duke u lidhur me Mediocredito Centrale, instruksionet e disbursimit të marra fillimisht nga vetë Mediocredito Centrale.

11.3 Mediocredito Centrale nuk do t'u japë rrugë kërkesave të disbursimit (neni 6.4), në rast se nuk janë të disponueshme shumat nga ana e autoriteteve kompetente italiane.

Neni 12

Mospagimi i interesit

12.1 Në rast se, për një arsye çfarëdo, për të cilën nuk është përgjegjës Huamarrësi, shumat e principalit dhe/ose interesave nuk kthehen brenda afatit në bankën agjente brenda datës të skadimit, Huamarrësi është i detyruar të paguajë kamatëvonesat e këtyre shumave për periudhën midis datës së mbarimit të afatit dhe datës së akreditimit efektiv në favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve ligjorë pranë vetë bankës agjente.

12.2 Këto kamatëvonesa do të llogariten në masë 0,40% për 35 ditët e mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar dhe menjëherë më pas, në masë 5% deri në datën e pagesës efektive në Mediocredito Centrale.

12.3 Për 35 ditët menjëherë të mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar këto kamatëvonesa do të llogariten gjithnjë me regjimet e interesave të thjeshta; për periudhën e mëpasshme ato do të llogariten me regjimin e interesit të thjeshtë, kur kjo periudhë është më e vogël se një vit dhe me regjimin e interesit të thjeshtë të kombinuar, kur kjo periudhë është më e madhe se një vit.

Neni 13

Rimbursimi i kuotave të kredisë financiare në rast të mosrealizimit të programeve/projekteve

13.1 Në rast mungese apo realizimi të pjesshëm të projekteve/programeve, Huamarrësi do të rimbursojë shumat e ngelura, përfshirë edhe ato të livruara si parapagim, në bazë të kushteve të përcaktuara ndërmjet MCC-së, dhe autoriteteve kompetente italiane.

Neni 14

Detyrime tatimore

14.1 Në bazë të nenit 9.2 të mësipërm, çdo detyrim tatimor, aktual apo i ardhshëm për çfarëdo lloj detyrimi në Shqipëri, në varësi të Marrëveshjes financiare në fuqi dhe të deklaratës së borxhit relativ me të, do të jetë ekskluzivisht në ngarkim të Huamarrësit.

14.2 Çdo detyrim tatimor në Itali, në varësi të Konventës financiare nuk do jetë në ngarkim të Huamarrësit.

14.3 Mediocredito Central deklaron se do të përdorë regjimin fiskal në nenin 19 të dekretit të Presidentit të Republikës nr.601 të 29 shtatorit 1973 siç mund ndryshohet kohë pas kohe.

Neni 15

Ligji i zbatueshëm

15.1 Kjo Marrëveshje financiare është hartuar në bazë të ligjit italian.

Neni 16

Mosmarrëveshje të mundshme

16.1 Palët do të përpiqen të zgjidhin miqësisht çdo lloj mosmarrëveshje që vjen nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Konvente financiare.

16.2 Në rast se përpjekje të tilla, brenda një kohe të arsyeshme, nuk do të çonin në zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, këto do të zgjidhen në nivel qeveritar.

16.3 Në rast se një përpjekje e tillë nuk do të bëhej (ose do të bëhej), por nuk do të çonte në një zgjidhje të kënaqshme, të gjitha mosmarrëveshjet që vijnë nga kjo Konventë financiare apo që kanë lidhje me të do të zgjidhen përfundimisht sipas rregullores së arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, Francë, nga një trup arbitror i përbërë nga tre anëtarë:

- një i caktuar nga Huamarrësi;

- një i caktuar nga MCC;

- një i caktuar nga arbitrat e mësipërm ose, në rast mosmarrëveshjesh, nga Presidenti i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare të Parisit.

16.4 Në rast se Huamarrësi ose Mediocredito Centrale nuk kanë caktuar arbitrin e tyre brenda 30 ditëve duke filluar nga kërkesa e palës tjetër, arbitri do të caktohet nga Presidenti i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris.

Vendimi i trupit arbitror, i cili do të gjykojë sipas ligjit italian, do të jetë përfundimtar dhe i pakundërshtueshëm nga të dyja palët pa asnjë mundësi apelimi.

Pavarësisht nga çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes palëve, Huamarrësi duhet të paguajë në afatet e caktuara, të gjitha shumat në varësi të kësaj Konvente financiare dhe në veçanti të gjitha shumat që rrjedhin nga planet për shlyerje, të përcaktuara në nenin 8 dhe nga deklaratat e borxhit në vijim.

Neni 17

Njoftime

17.1 Çdo njoftim që duhet zbatuar në lidhje me këtë Konventë financiare duhet të drejtohet në adresat e mëposhtme:

- Ministria e Financave: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" - Tiranë Shqipëri;

- Mediocredito Centrale - Via Piemonte 51, 00187 Roma - ITALIA;

- Projecte & Export Finance-Istruttoria Convenzioni Finanziarie: Tel 0039-06-4791-2592/2749/2218/2200, telefax N 0039-06-4791-2574/2970
- Servizio Amministrazione Finanziamenti Strutturati: Tel 0039-06-4791-2380/2249/2516/2206, Telefax n. 0039-06-4791-2059/2758;
N.swift MCENITRR
- Banka agjente:.....

Neni 18

Origjinalet e Konventës financiare

18.1 Kjo Konventë financiare është hartuar dhe nënshkruar në tre origjinalë në gjuhën italiane dhe në tre origjinalë në gjuhën angleze. Në rast mosmarrëveshjeje zbatohet teksti i hartuar në gjuhën italiane.

Palët kanë nënshkruar Konventën financiare në ditën dhe vendin e treguar.

MINISTRIA E FINANCAVE E SHQIPËRISË

MEDIOCREDITO CENTRALE

FORMA E URDHËRIT PËR BANKËN AGJENTE

ANEKSI A

nga:.....(Huamarrësi)
për:.....(banka agjente)
për: Mediocredito Centrale (për njohur)

Konventa financiare prej 41 528 041.03 (dyzetë e një milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë e dyzet e një pikë zero tre) euro e nënshkruar prej nesh në..... datë.....dhe nga Mediocredito Centrale në.....datë.....

Në zbatim të kësaj Konvente financiare, ju emërojmë me anë të këtij mandati si bankën tonë agjente.

Për rrjedhojë, do të hapni në emrin tonë një "Llogari me jashtë" pranë bankës suaj, në të cilën do të kreditohen fondet që Mediocredito Centrale do të vërë herë pas here në dispozicionin tonë.

Fondet e kredituara nga Mediocredito Centrale në llogarinë sa më sipër do të përdoren ekskluzivisht për pagesën e....., sipas udhëzimeve që do t'ju japim nëpërmjet një letre të veçantë hartuar sipas aneksit C, bashkëlidhur kësaj Konvente.

Kini mirësinë të na konfirmoni, me letër ose telex, që duhet të konfirmohet më pas me një

letër, në dhe Mediocredito Centrale, pranimin e këtij mandati nga ana juaj.
Përsëritet të përzemërta.

FORMA E KËRKESËS PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË FONDEVE
ANEKSI B

Nga:.....(Huamarrësi)
Për:.....Mediocredito Centrale
Konventë financiare prej 41 528 041.03 (dyzet e një milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë e
dyzet e një pikë zero tre) euro nënshkruar nga ne
Mëdhe nga Mediocredito Centrale në.....më.....

Në bazë të nenit 6 të kësaj Konvente, ju kërkojmë të vini në dispozicionin tonë për kreditim në
“Llogarinë me jashtë”, të hapur në emrin tonë pranë filialit të Romës.....,
ekuivalentin në euro të.....(.....) (shuma kontraktuale që mbulohet nga
kjo kredi).

Saktësojmë që kjo shumë korrespondon me pagesat që duhet të bëjmë për..... në
bazë të kontratës së furnizimit nr.....datëmidis.....,në lidhje me
..... (projektin/programin), për të cilën konfirmojmë rregullsinë, një kopje e të cilës do
t’ia dërgojë eksportuesi italian.

Me qëllim lehtësimin e pagesave në favor të....., i kemi dhënë udhëzime
filialit të Romëst’ju kërkojmë direkt, herë pas here, kërkesat për kreditim në
“Llogarinë me jashtë” të fondeve të nevojshme për kryerjen e pagesave të parashikuara në kontratën e
furnizimit sa më sipër, sipas kushteve dhe mënyrave që përcaktohen në të.

Me anë të kësaj kërkesë, marrim përsipër detyrimin e pakushtëzuar dhe të përvokueshëm për

të shlyer çdo shumë të kredituar nga ju në “Llogarinë me jashtë” sipas mënyrave që përcaktohen në këtë Konventë.

Brenda 60 ditëve nga afati i fundit për disbursimin e fundit të kredisë financiare të parashikuar në nenin 4 të kësaj Konvente, marrim përsipër detyrimin t’ju lëshojmë një njohje borxhi për shumën e principalit të barabartë me gjithë shumën e disbursuar në bazë të kësaj Konvente financiare.

Kjo njohje borxhi hartohet në përputhje me aneksin E, bashkëlidhur kësaj Konvente.

Përshëndetje të përzemërta.

FORMA E LETRËS SE UDHËZIMEVE PËR BANKËN AGJENTE ANEKSI C

Nga:.....(Huamarrësi)

Për:.....(bankën agjente)

Për: Mediocredito Centrale (kopje)

Konventë financiare prej 41,528,041.03 (dyzet e një milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë e dyzet e një pikë zero tre) euro nënshkruar nga ne, në mëdhe nga Mediocredito Centrale nëmë.....

-

Në bazë të nenit 6 të kësaj Konvente financiare dhe në vijim të letrës sonë datë..... me anë të së cilës ju kemi emëruar si bankën agjente, ju dërgojmë bashkëlidhur (eksportuesi italian do t’ju dërgojë) një kopje të kontratës së furnizimit nr..... datë ... lidhur midis në lidhje me(projektin/programin) për të cilin deklarojmë që kemi njohje të plotë.

Me anë të kësaj letre ju kërkojmë, me cilësinë e bankës sonë agjente, të kryeni pagesat e parashikuara në kontratën e furnizimit sa më sipër sipas kushteve dhe mënyrave të përcaktuara në të, në favor të....., deri në një shumë maksimale të barabartë me euro.(.....)

(shumë kontraktuale që mbulohet nga kjo kredi).

Pagesat që do të kryeni në favor të eksportuesit/ve italianë të treguar nga ne, janë nën vartësinë e dorëzimit nga eksportues/se të tillë të dokumentacionit sipas kontratës (p.sh. fatura, gjendja e avancimit të punimeve etj.) dhe nga lëshimi i këtij të fundit të një kuitance në dy origjinale.

Për sa u tha më sipër, do t’i dorëzohet Mediocredito Centrale një kopje vërtetuar me origjinalin e dokumentacionit të sipërpërmendur dhe një origjinal i faturës së derdhjes dhe të na trasmetohet ne origjinali i dokumentacionit kontraktual dhe kopja e dytë origjinale e faturës së derdhjes.

Gjithashtu, ju kërkojmë që herë pas here të kryeni direkt tek Mediocredito Centrale, kreditimin në “Llogarinë me jashtë” të fondeve të nevojshme për kryerjen e pagesave të parashikuara në kontratën e furnizimit, sipas kushteve dhe mënyrave të përcaktuara në të (çdo kërkesë duhet të na dëgohet me teleks, faks ose swift për dijeni).

Ju bëjmë të ditur lidhur me këtë çështje se i kemi kërkuar Mediocredito Centrale të kreditojë herë pas here në Llogarinë me jashtë, në bazë të kërkesës suaj, fondet e nevojshme për kryerjen e pagesave në favor të për llogarinë tonë.

Kini mirësinë të na konfirmoni, me anë të një letre ose telex-i që duhet konfirmuar më pas me një letër, ne dhe Mediocredito Centrale, pranimin e këtyre udhëzimeve nga ana juaj.

Përshëndetje të përzemërta.

FORMAT E KËRKESËS PËR DISBURSIM ANEKSI D

Nga:.....(banka agjente)

Për:..... Mediocredito Central

Për:.....Huamarrësi (kopje)

Konventë financiare prej 41 528 041.03 (dyzet e një milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë e dyzet e një pikë zero tre) euro nënshkruara nga ne..... datëdhe Mediocredito Centrale nëdatë.....

Në bazë të kësaj Konvente, mandatit dhe udhëzimeve të (Huamarrësi), ju kërkojmë të kreditoni brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kësaj letre, euro(.....) në “Llogarinë me jashtë” të hapur pranë nesh në emër të(Huamarrësi).

Kjo shumë do të përdoret për kryerjen e pagesave në favor të, pagesat që bëhen të detyrueshme nga dokumentet kontraktuale të mëposhtme lidhur me kontratën furnizuese nr.....datë.....lidhur midis.....dhe.....

.....
.....
.....

Lidhur me këtë çështje, vërtetojmë se dokumentacioni i mësipërm kontraktual, një kopje e të cilit do t’ju dërgohet është i rregullt dhe në përputhje me kontratën furnizuese së cilës i referohet.

Vërtetojmë gjithashtu që pagesat sa më sipër përputhen me ligjet monetare në fuqi në Itali.

Përsëritet të përzemërta.

FORMA E NJOHJES SË BORXHIT ANEKSI E

.....(Huamarrësi)

nr.....

Vendi dhe data e lëshimit:

.....

Në zbatim të Konventës financiare midis(Huamarrësi), si agjent dhe për llogari të Qeverisë së..... dhe Mediocredito Centrale, nënshkruar në me dhe nëme.....,(Huamarrësit) deklarohet se ka marrë nga Mediocredito Centrale shumën e mëposhtme:

.....me.....
.....me.....
.....me.....
.....

Si rrjedhim,(Huamarrësi) deklarohet se është debitor në mënyrë të pakushtëzuar dhe të përvokueshme ndaj Mediocredito Centrale S.p.a: -me seli në Romë (Itali), Via Piemonte 51, për shumën e principalit prej euro.(.....) dhe merr përsipër detyrimin ta shlyejë këtë shumë në (.....) kështu simestrale, të barabarta dhe të njëpasnjëshme, ku të parit kështu i mbaron afati mëdhe të fundit....., sipas planit të mëposhtëm të shlyerjes.

Mbi shumën e principalit të ngulur të deklaruar në këtë njohje borxhi,.....

(Huamarrësi) merr përsipër detyrimin të paguajë interesat sipas planit të shlyerjes bashkëngjitur, të llogarit në përputhje me kushtet e kësaj Konvente financiare.

.....(Huamarrësi) do të kthejë kuotat e principalit dhe do të paguajë interesat e parashikuara në këtë njohje borxhi, duke i kredituar këto shuma brenda afateve përkatëse të rëna

dakord në euro në favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve ligjorë, në filialin e Romës,.....("Banka Agjente"), pa zbritur asnjë detyrim bankar dhe/ose valutor.

Në rast se, për një arsye çfarëdo, për të cilën nuk është përgjegjëse Mediocredito Centrale, shumat e principalit dhe interesit, të përcaktuara në këtë njohje borxhi, nuk derdhen brenda afatit për të cilin është rënë dakord, në filialin e Romës,, (Huamarrësi) është i detyruar të paguajë, mbi këto shuma, kamatëvonesa për periudhën nga data e mbarimit të fundit dhe datës së kreditimit efektiv në filialin e Romësnë favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve ligjorë të caktuar nga vetë banka.

Këto kamatëvonesa do të llogariten në masën% për 35 ditë pas mbarimit të afatit fillestar dhe më pas, në masën 5% deri në datën e kreditimit aktual në favor të Mediocredito Centrale.

.....

Sigla e Huamarrësit

Për 35 ditë pas datës së mbarimit të afatit fillestar, këto kamatëvonesa do të llogariten gjithnjë me regjimin e interesave të thjeshta; për periudhën e mëpasme do të llogariten me regjimin e interesave të thjeshta, kur kjo periudhë është më e vogël se një vit dhe me regjimin e interesave të kombinuara, kur kjo periudhë është më e gjatë se një vit.

Filiali i Romës do të regjistrojë herë pas here në këtë njohje borxhi, çdo pagesë të bërë për principalin dhe interesin.

Me kryerjen e gjithë pagesave të parashikuara në planin e shlyerjes si më poshtë, kjo njohje borxhi i kthehet(Huamarrësit).

Kjo njohje borxhi lëshohet për kredinë financiare prej euro.....

(.....) dhënë në bazë të nenit 6 të ligjit italian nr.49, datë 26 shkurt 1987.

PLANI I SHLYERJES

	Mbarimi i afatit	Kuota e principalit	Kuota e interesit	Totali
a)				
b)				
c)				
d)				
1)				
2)				
3)				
4)				
5)				
6)				
7)				
8)				
9)				
10)				

.....

(Firma e Huamarrësit)

FORMA E FATURËS SË DERDHJES (PAGESËS)

ANEKSI F

Nga: Eksportuesi italian
Për: (Huamarrësin)
Për: Mediocredito Centrale

FATURA E DERDHJES

Në bazë të kontratës furnizuese nr. të nënshkruar në datë
midis kësaj shoqërie dhepër furnizimin e, kjo shoqëri deklaron se ka
marrë në dorëzim shumën në euro prej me rregullim të pjesshëm/totale të kësaj
kontrate.

Kjo shumë lidhet me kredinë financiare prej 41 528 041.03 (dyzet e një milionë e pesëqind e
njëzet e tetë mijë e dyzet e një pikë zero tre) euro të vëna në dispozicion nga Mediocredito Centrale,
Qeverisë së, në bazë të nenit 6 të ligjit italian nr.49 datë 26.9.1987 siç mund të
ndryshohet herë pas here, me anë të kësaj Konvente financiare të nënshkruar në
datë..... dhe në Romë datë

Kështu, ne deklarojmë se kemi paguar të plotë shumën e duhur të kredisë financiare në
shumën prej euro(.....), dhe se Huamarrësi dhe MCC nuk janë përgjegjës për çdo dhe të
gjitha detyrim/et dhe përgjegjësi më lidhje me shumën e marrë.